

The top of the page features a blue background with the white stars of the European Union flag on the left and a white outline map of Europe on the right. Below this is a solid yellow horizontal band.

**The European Union's IPA Programme**

**Strategjia dhe Axxhenda e  
Veprimit e SELDI-it**

*Per Mireqeverisjen dhe Anti-  
Korrupsionin ne Evropen Juglindore*

**SELDI**

Southeast Europe Leadership  
for Development and Integrity

[www.seldi.net](http://www.seldi.net)

*Strategjia dhe Axhenda e Veprimit të SELDI-it* përcakton misionin dhe qëllimet e koalicionit SELDI deri në fund të vitit 2016 dhe përshkruan veprimet specifike të rrjetit. SELDI është një nismë e hapur, duke synuar vazhdimisht të zgjerohet dhe të tërheqë organizatat e shoqërisë civile (OJF-të), politikëbërësit dhe palë të tjera, të cilët mund të kontribuojnë në qëllimet e tij, të ndajnë përvojën dhe të mbështesin mirëqeverisjen dhe masat anti-korrupsion në vendet e Europës Jug-Lindore.


Janë konsultuar 140 palë të interesuara anti-korrupsion (OJF, politikëbërës, organizata ndërkombëtare, studiues dhe gazetarë nga 9 vende), të cilët ofruan komente/informacione të vlefshme për përmirësimin e *Strategjise dhe Axhendës së Veprimit të SELDI-it*.

**Anëtarët themelues të koalicionit SELDI:**

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), Shqipëri  
Qendra për Tranzicion Demokratik, Mali i Zi  
Qendra për Raportim Investigativ (CIN), Bosnje Hercegovinë  
Qendra për Studime Liberal-Demokratike (CLDS), Serbi  
Qendra për Studimin e Demokracisë (CSD), Bullgari  
Forum i Veprimit Qytetar FORCA Pozega, Serbi  
Shtëpia e Europës (HoE), Shqipëri  
Instituti Alternativ (IA), Mali i Zi  
Instituti për Demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSCS), Republika e Maqedonisë  
INSTITUTI RIINVEST, Kosovë  
Instituti i Kosovës për Drejtësi (KLI), Kosovë  
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCIC), Republika e Maqedonisë  
Instituti i Ohrit për Strategji Ekonomike dhe Çështje Ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë  
Partneriteti për Zhvillimin Social (PSD), Kroaci  
Sekretariati Rajonal i Iniciativës Anti-korrupsion (RAI), Bosnje Hercegovinë  
“Syri i Vizionit”, Kosovë  
Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Sociale (TESEV), Turqi

ISBN:

2013, Udheheqja e Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI)

 Creative Commons License

Attribution-NonCommercial-NoDerivs 3.0 Unported

Qender për Studimin e Demokracisë

5 Alexander Zhendov Str.

1113 Sofia

tel.: (+359 2) 971 3000

fax: (+359 2) 971 2233

csd@online.bg

www.csd.bg



Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përmbajta e këtij dokumenti është përgjegjësi e iniciativës së SELDI-it dhe në asnjë mënyre nuk mund të konsiderohen si pikëpamje të Bashkimit Europian.

## Përmbajtja e Lëndës

I. Sfondi i Problemit.....	4
II. Strategjia Leadership i Europës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet .....	6
III. Misioni.....	7
IV. Objektivat.....	7
V. Mjetet.....	8
VI. Veprimet.....	9
VII. Përsosmëri organizative dhe njohurish .....	12
VIII. Qeverisja e SELDI-t .....	16
IX. Sinergjia me iniciativa të tjera të BE-se dhe ndërkombëtare .....	18
X. Rezultatet dhe Ndikimet e pritshme .....	18
XI. Qendrueshmeria .....	20
Annex 1. Anëtarët themelues të SELDI-t.....	21
Aneksi 2. Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit .....	24

**I. Sfondi i Probleme** Korrupsioni është një nga çështjet më të ngutshme në Europën Juglindore. Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për Drogën dhe Krimin (UNODC) korrupsioni është një çështje shqetësuese për vendet e Ballkanit Perëndimor, për shkak të ndikimit të dëmshëm që ka në zhvillimin ekonomik dhe social. Në vitin 2010, mesatarisht, një në gjashtë qytetarë të rajonit ka pasur ekspozim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në një akt ryshfeti me një zyrtar publik në një bazë vjetore<sup>1</sup>.

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International për vitin 2012<sup>2</sup>, Shqipëria ka nivelin më të lartë të korrupsionit në sektorin publik në Europën Juglindore, në renditjen e 113-ta (nga 176 vende), e ndjekur nga Kosova (nën UNSCR 1244/99) – në vend të 105-të, Serbia (e 80-ta), Bullgaria and Mali i Zi (të dy të renditur në vendin e 75-të), Bosnje Hercegovina (e 72-ta). Në vend të 54-t renditet Turqia, më e mira në rajon, por rezultati i saj ende tregon se vendi perceptohet nga qytetarët e saj si “i korruptuar” dhe jo “i pastër” . Vendet e rajonit përballen me çështje të përbashkëta në luftën kundër korrupsionit. Shumica e vendeve të rajonit kanë hartuar strategji qeveritare dhe institucione për të luftuar korrupsionin, por zbatimi mbetet i dobët.<sup>3</sup> Bazuar në raportet e analizës së Komisionit European mbi progresin e vendeve të rajonit, ne vijim identifikohen **problemet më të përbashkëta në luftën kundër korrupsionit në Europën Juglindore:**

- Legjislacioni për financimin e partive nuk është adaptuar siç duhet ose është joefektiv (8 vende);
- Bashkëpunim dhe koordinim i pakënaqshëm ose problematik ndërmjet institucioneve (6);
- Kapaciteti i ulët investigativ dhe prokurori e dobët (6);
- Legjislacioni i dobët i prokurimeve publike dhe zbatimit të ligjit (6);
- Kapaciteti i ulët administrativ i inspektiveve financiare publike (5);
- Gjykime të gjata ose të pezulluara, pak dënime, dënime të papërshtatshme ose të pakënaqshme (5);
- Mekanizëm i dobët monitorimi për politikën anti-korrupsion (5), etj.

Korrupsioni është mohimi i sundimit të ligjit dhe mirëqeverisjes, dhe një pengesë për zbatimin efikas të ligjit dhe funksionimit efektiv të institucioneve publike. OJF-të e angazhuara në rajon është e nevojshme të gjejnë një platformë të përbashkët me institucionet shtetërore dhe të punojnë për ta

<sup>1</sup>UNODC, 2011, *Corruption in the Western Balkans: Bribery as Experienced by the Population*, Vienna.

<sup>2</sup>Transparency International, 2012, Corruption Perception Index.

<sup>3</sup> Stefanov, R., Hristov D., *Corruption in South East Europe*, Chapter 4 in Handbook of Doing Business in South East Europe, Sternad, D. and Doering T. (eds), Palgrave Macmillan 2012. The numbers in the brackets denote the number of countries, in which the EC has outlined the respective issue as a problem. The total number of countries reviewed is 9.

parandaluar atë. Zvogëlimi i korrupsionit kërkon jo vetëm masat e duhura institucionale, por edhe krijimin e parakushteve sociale për vendosjen e sundimit të ligjit. Kjo është një detyrë e vështirë për OJF-të në një rajon që vuan mungesën e financave publike dhe me kapacitet dhe iniciativë të ulët të sektorit privat. **OJF-të në rajon përballen me një tërësi ngjashmërisht në mungesën e kapaciteteve dhe në problemet që ndeshin në zhvillimin e tyre, si:**

- Burimet e pamjaftueshme dhe të papërshtatshme njerëzore;
- Dobësi financiare;
- Menaxhim dhe planifikim strategjik të dobët;
- Mungesë të informacionit mbi politikat kombëtare;
- Nivel të ulët të kapacitetit analitik;
- Mbështetje e dobët publike dhe në përfaqësim;
- Rrjet joefektiv dhe i paqëndrueshëm<sup>4</sup>.

Ka shumë mundësi për shkëmbim njohurish dhe informacioni ndërmjet vendeve të rajonit lidhur me mirëqeverisjen dhe anti-korrupsionin. Rrjeti **Lidershipi i Europës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet (SELDI)** mbledh sëbashku drejtues të OJF-ve të rajonit duke i ndihmuar të krijojnë mundësi të reja për pëmirësimin e qeverisjes dhe të anti-korrupsionit.

Perspektiva për antarësimin në Bashkimin Europian ka krijuar një kuadër të përgjithshëm të favorshëm politik anti-korrupsion në Europën Juglindore. Të ndihmuara nga komuniteti ndërkombëtar dhe veçanërisht nga Komisioni Europian dhe institucione të tjera Europiane, vendet e Ballkanit Perendimor dhe Turqia kanë ndërmarrë një numër hapash për të luftuar korrupsionin.

Janë ndërmarrë një numër iniciativash për mireqeverisje dhe anti-korrupsion të mbështetura nga Komisioni Europian si dhe nga UNODC, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Banka Botërore, Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Iniciativa e Europës Qendrore (CEI), Iniciativa Rajonale Anti-korrupsion (RAI), etj. Një mësim kyç i përbashkët ka qenë se presioni ndërkombëtar dhe financimi duhet të plotësohet me platforma të natyrshme, dinamike të OJF-ve të afta për të monitoruar vazhdimisht situatën, për të rritur ndërgjegjësimin për çështje shqetësuese, duke mësuar nga organizatat e ngjashme në rajon dhe duke ngritur koalicione me partnerë qeveritarë, jo-qeveritarë dhe ndërkombëtarë për të vepruar në çështje specifike.

<sup>4</sup> Sterland, B., Rizova, G., 2010, *Civil Society Organisations' Capacities in the Western Balkans and Turkey: a Comparative Summary of the Eight Country CSO Needs Assessment*, TACSO, October 2010.

Kjo *Strategji dhe Axhendë Veprimi* synon të krijojë një platformë të tillë, duke përdorur gjithashtu përpjekjet dhe rezultatet e mëparshme të Nismës për Zhvillimin Ligjor të Europës Juglindore të viteve 2001-2002 dhe duke marrë parasysh përpjekjet për të transformuar Paktin e Stabilitetit për Europën Juglindore në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal me Inicativën e tij Rajonale Anti-korrupsion. Strategjia e propozuar do të përfitojë gjithashtu nga vëmendja në rritje kundër korrupsionit në Strategjinë e Zgjerimit të BE-së dhe në vetë BE-në në dekadën e shkuar. Komisioni Europian (EC) ka përfshirë në 2007-tën për herë të parë në historinë e tij një mekanizëm post-aderimit për monitorimin e progresit kundër korrupsionit në Bullgari dhe në Rumani - Mekanizmi për Bashkëpunim dhe Verifikim. Kapitulli 23, Të drejtat Juridike dhe Themelore dhe kapitulli 24 Drejtësia, Liria dhe Siguria janë bërë pika kyçe e negociatave për antarësimin e Kroacisë në BE dhe do të mbeten fokus kryesor i negociatave për antarësimet në BE në të ardhmen. Lufta kundër korrupsionit ka qenë identifikuar ndër sfidat kryesore të Strategjisë për Zgjerim të BE-së për vitin 2011, 2012 dhe 2013.<sup>5</sup> Në nivel europian, Komisioni Europian ka nënvizuar në vitin 2011 një Komunikatë ambicioze për *luftën kundër korrupsionit në BE*, e cila parashikon futjen e një mekanizmi për vlerësim periodik të përpjekjeve të shteteve të BE-së në luftën kundër korrupsionit - *Raporti Anti-korrupsion i BE-së*<sup>6</sup>. Raporti i parë pritet të publikohet gjatë 2013-tës.

Tabela 1. Pikat e dobëta të përbashkëta lidhur me korrupsionin në vendet e Europës Juglindore

Proces privatizimi që ushqen korrupsionin
Vështirësi në tërheqjen e investimeve të huaja
Mjedis i favorshëm ndaj grupeve të krimit të organizuar
Sektor informal i konsiderueshëm
Nivel i lartë i papunësisë, që është theksuar edhe për shkak të krizës ekonomike globale

## II. Strategjia Leadership i Europës

### Juglindore për Zhvillim dhe Integritet

*Strategjia dhe Axhenda e Veprimit e SELDI-it* përshkruan misionin dhe vendos qëllimet e koalicionit SELDI deri në fund të vitit 2016. Ajo paraqet

<sup>5</sup>European Commission, 2011, Enlargement Strategy and Main Challenges 2011 – 2012, COM(2011) 666 final, Brussels, 12.10.2011 and European Commission, 2012, Enlargement Strategy and Main Challenges 2012-2013, COM (2012), 600 final.

<sup>6</sup>Communication from the Commission to the European Parliament, the Council and the European Economic and Social Committee *Fighting Corruption in the EU*, COM/2011/0308 final

veprimet specifike të rrjetit gjatë dy viteve të ardhshme deri në fund të vitit 2014. Ky dokument do të perditesohet sipas nevojave në gjysmën e dytë të vitit 2014. SELDI është një iniciativë e hapur, duke synuar vazhdimisht të tërheqë dhe të përfshijë OJF-të, politikëbërës, dhe palë të tjera të interesuara, të cilët mund të kontribuojnë në arritjen e objektivave, të ndajnë përvojën dhe të mbështesin masat anti-korrupsion në rajon.

Anëtarët themelues të SELDI-it përfshijnë 17 OJF nga nëntë vende të rajonit:

1. Qendra për Studimin e Demokracisë (CSD), Bullgari - koordinator
2. Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), Shqipëri
3. Shtëpia e Europës (HoE), Shqipëri
4. Qendra për Raportim Investigativ (CIN), Bosnje Hercegovinë
5. Partneriteti për Zhvillimin Social (PSD), Kroaci
6. INSTITUTI RIINVEST, Kosovë
7. “Syri i Vizionit”, Kosovë
8. Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCIC), Republika e Maqedonisë
9. Instituti për Demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSCS), Republika e Maqedonisë
10. Instituti i Ohrit për Strategji Ekonomike dhe Çështje Ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë
11. Qendra për Tranzicion Demokratik (CDT), Mali i Zi
12. Instituti Alternativ (IA), Mali i Zi
13. Qendra për Studime Liberal-Demokratike (CLDS), Serbi
14. Forumi për Veprim Qytetar FORCA Pozega, Serbi
15. Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Sociale (TESEV), Turqi
16. Sekretariati i Nismës Rajonale Anti-korrupsionit (RAI), Bosnje Hercegovinë
17. Instituti i Kosovës për Drejtësi (KLI), Kosovë

### III. Misioni

Misioni i Lidershit të Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet është forcimi i kapaciteteve të OJF-ve të rajonit për të bashkëpunuar, monitoruar dhe për të ndikuar mirëqeverisjen kundër korrupsionit në Europën Juglindore dhe në Turqi nëpërmjet partneritetit publik-privat.

### IV. Objektivat

*Strategjia dhe Axhenda e Veprimit e SELDI-it* synon të shërbejë si një plan-veprimi për koalicionin e OJF-ve, por gjithashtu si një deklaratë e vlefshme, e cila mund të përdoret për tërheqjen e partnerëve të rinj dhe për të informuar dhe për të motivuar palë të tjera të interesuara. *Axhenda e Veprimit* ka për qëllim të nxisë legjitimitetin e partneritetit dhe do të përmirësojë transparencën dhe llogaridhënien. Për më tepër, *Axhenda e Veprimit* vendos në fokusin e vet përmirësimin e mjedisit për aktivizmin qytetar dhe dialogun

shtet-shoqëri civile në nivel rajonal dhe kombëtar, mbi të cilat OJF-të dhe palët e tjera të interesuara do të bien dakord për të vepruar.

**Objektivat specifike** të *Strategjisë dhe Axbendës së Veprimit* janë:

- Të ndërtojë një **koalicion** anti-korrupsion dhe të mirëqeverisjes të OJF-ve që kanë aspirata të përbashkëta në Europën Juglindore;
- Të rrisë **kapacitetin e OJF-ve, njohuritë dhe angazhimin** për të siguruar analiza, monitorim dhe avokim mbi politikatat, masat dhe reformat që lidhen me mirëqeverisjen dhe anti-korrupsionin dhe të nxisë bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e OJF-ve përtej niveleve kombëtare dhe rajonale;
- Të promovojë dialogun **shtet-shoqëri civile** dhe të përmirësojë mjedisin për aktivizmin qytetar në nivel rajonal dhe kombëtar;
- Të kontribuojë në rritjen e **mbështetjes publike/qytetare** dhe në pjesëmarrjen në masat anti-korrupsion dhe mirëqeverisjen;
- Të ndihmojë vetë **OJF-të** të përmirësojnë legjitimitetin e tyre, transparencën dhe llogaridhënien.

## V. Mjetet

*Strategjia dhe Axbenda e Veprimit* bazohet në tre shtylla kryesore:

- **Ndërtimi i institucioneve:** ngritja e koalicionit të OJF-ve nëpërmjet zhvillimit dhe miratimit të *Strategjisë dhe Axbendës së Veprimit* të OJF-ve aktuale dhe konstituimit të strukturës qeverisëse të koalicionit të OJF-ve - Komiteti Drejtues dhe Bordi Ndërkombëtar Këshillimor. CSD do të veprojë si sekretariat për këtë nismë. Ndërveprimi mes anëtarëve të koalicionit do të zbatohet nëpërmjet:
  - Pjesëmarrjes në takimet e SELDI-it;
  - Konsultimit mbi rezultatet kryesore të evokimit - raporte rajonale dhe kombëtare anti-korrupsion;
  - Mbulimit mediatik, duke përfshirë faqe interneti dhe media.
- **Mbikqyrja:** zbatimi i një roundi dyvjeçar të *Sistemit të Monitorimi të Korrupsionit (CMS)*. CMS është ndërtuar dhe zhvilluar nga Qendra për Studimin e Demokracisë. CMS ishte i pari në llojin e vet në vendet ish-socialiste për të kombinuar resurse të rëndësishme kërkimore dhe potenciale të fuqishme anti-korrupsion. Qëllimi i CMS është matja e nivelit të korrupsionit në një vend, si dhe identifikimi i perceptimeve publike, opinioneve dhe pritshmërive. CMS u vu në përdorim për herë të parë në vitin 1998 dhe një nga përfitimet e tij të dukshme është grumbullimi i të dhënave mbi strukturën dhe dinamikën e praktikave korruptive në Bullgari dhe në Europën Juglindore. Ai ka disa avantazhe të rëndësishme:
  - Koherenca me trajtimin sipas Kombeve të Bashkuara të viktimizimit në matjen e niveleve të korrupsionit administrativ;



- Bazueshmëria në burime të ndryshme të informacionit dhe kombinimi i metodave sasiore dhe cilësore për monitorim dhe vlerësim;
- Përdorimi i metodave të njohura kombëtare dhe ndërkombëtarisht dhe indikatorëve për vlerësimin e përhapjes aktuale të korrupsionit dhe perceptimit publik të tij;
- Krahasueshmëria dinamike e gjetjeve të monitorimit rreth zonës, fushave dhe formave të korrupsionit.

CMS është përshkruar në Shtojcën 2. Një përshkrim i detajuar i metodologjisë së CMS-së mund të gjendet në: “*E Ardhmja e Pastër. Plani i Veprimit Anti-Korrupsion për Bullgarinë. Monitorimi. Indekset e Vlerësimit të Korrupsionit*”, Qendra për Studimin e Demokracisë, Sofie, 1998, dhe në: “*Krimi pa Ndëshkim: Lufta ndaj Korrupsionit dhe Krimi i Organizuar në Bullgari*”, Qendra për Studimin e Demokracisë, Sofie, 2009.

CMS do të japë kontributin kryesor në *Raportet Kombëtare të Vlerësimit të Korrupsionit, Raportin Rajonal Anti-Korrupsion*, si dhe për *Mirëqeverisjen në vendet e Europës Juglindore*.

- **Avokimi:** iniciativa parashikon konsultime publike mbi masat e mundshme anti-korrupsion dhe rritjen e ndërgjegjësimit në shkallë rajonale, përmes takimeve të nivelit të lartë, konferencave të shtypit, dokumenteve mbi politikat, dhe publikimit të raporteve. Çdo ngjarje publike do të përdoret për të bashkërenduar palët e interesuara për të ecur sëbashku përpara në përputhje me *Axhendën e Veprimit*.

## VI. Veprimet

### Linja e veprimit 1: Ndërtimi i koalicionëve, Rrjetit dhe Konsultime me Palët e Interesuara

- **Ngritja e mekanizmit qeverisës të koalicionit të OJF-ve:** Komiteti Drejtues (SC) dhe Bordi Ndërkombëtar Këshillimor për Mirëqeverisje dhe Anti-korrupsion.
- **Bashkërendimi me koalicione të tjera të OJF-ve** në vendet e Europës Juglindore për të mundësuar marrëdhënie me të gjera me organizatat e tjera të shoqërisë civile, pale të interesuara dhe me qytetaret. Sigurimi i një shkalle me të larte të ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit do të garantojë njohje me të larte nga ana e institucioneve qeveritare për vlerën e pjesëmarrjes së OJF-ve në procesin e reformave.
- **Konsultime me palët e interesuara** mbi *Strategjinë dhe Axhendën e Veprimit* do të bëhen përmes dërgimit të drafteve tek një liste e paracaktuar palësh të interesuara (OJF-të, qeveri, administrate publike, dhe organizata

ndërkombëtare). Anëtarët e koalicionit të OJF-ve do të hyjnë gjithashtu në **konsultime të hapura dhe për një game të papërcaktuar idesh** me një komunitet me të gjere.

### Linja e veprimit 2: Ndërtimi i Kapaciteteve

- **Përgatitja e materialeve trajnuese dhe paketës metodologjike** mbi *Sistemin e Monitorimit të Korrupsionit* bazuar në instrumentet dhe raportet që janë në dispozicion.
- **Organizimi i një workshop-i mbi ndërtimin e kapaciteteve për monitorimin e korrupsionit**, për të trajnuar anëtarët e koalicionit të OJF-ve mbi metodat e monitorimit të korrupsionit, shembuj praktike dhe përgatitja e OJF-ve për të kryer vrojtime mbi korrupsionin dhe prezantimin e rezultateve tek politikëbërësit, mas-media dhe pale të tjera.

### Linja e veprimit 3: Diagnostikimi dhe Monitorimi i Korrupsionit

- **Grumbullimi i të dhënave dhe informacionit** mbi: (a) mekanizmat e praktikave korruptive që duhen analizuar dhe vrojtuar me tej; (b) efektiviteti i përpjekjeve të qeverisë për të luftuar korrupsionin dhe problemet specifike të vendit që duhen adresuar; (c) nevojat specifike për ndryshime në hartimin e politikave dhe në legjislacionin anti-korrupsion për të strukturuar me mirë strategjinë e projekteve dhe fokusimi në raportet dhe rekomandimeve mbi politikën e ardhshme; (d) fokusimi mbi problemet specifike të një vendi, si dhe në metodologjinë për të bërë që të dhënat baze dhe rezultatet të jenë me objektive dhe të besueshme, nëse do të jete e nevojshme.
- **Grumbullimi i informacionit të disponueshëm** për të plotësuar *Sistemin Monitorues të Korrupsionit (CMS)*. Ky ka për qëllim të kërkojë dhe analizoje në thellësi të dhënat dhe informacionin e mbledhur në hapat e mëparshëm. Do të identifikojë mangësitë dhe nevojat e politikave dhe ato legjislative, zhvillimet e fundit dhe praktikën me të mira, rekomandimet e mundshme politike. Studimi do të prodhojë një **raport për çështjet kyçe të mirëqeverisjes dhe mangësitë anti-korrupsion të identifikuar**. Grumbullimi i informacionit do të plotësojë rezultatet e *Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit* dhe do të përdoret për të informuar *Raportet Kombëtare të Vlerësimit të Korrupsionit (CARs)* si dhe për *Raportin Rajonal Anti-korrupsion (RAR)*.
- **Diagnozat e korrupsionit – kryerja e monitorimit të korrupsionit** nëpërmjet *Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit* në të gjitha vendet e koalicionit për të identifikuar prirjet e korrupsionit dhe pikat e nxehta. Monitorimi do të zbulojë nivelin e viktimizimit nga korrupsioni, presionin e korruptimit nga administrata publike, pranueshmërinë dhe ndjeshmërinë ndaj

korrupsionit si dhe pritshmëritë mbi perspektivat e suksesit në luftën kundër korrupsionit.

#### **Linja e veprimit 4: Mbështetje për Hartimin e Politikave të Bazuara mbi Te dhëna dhe Avokim**

- Bazuar në te dhënat e grumbulluara dhe në rezultatet e CMS, SELDI do të prodhojë *Raporte për Vlerësimin e Korrupsionit* specifike për çdo vend. *Raportet për Vlerësimin e Korrupsionit* do të prezantojnë një dokument gjithëpërfshirës të politikave për çdo vend. Drafti i përfundimeve të çdo raporti do të **konsultohet me palët përkatës të interesuara kombëtare dhe rajonale** për të ndihmuar në sjelljen sëbashku të perspektives publike dhe asaj private në një përpjekje për të ndërtuar konsensus. CARs do të finalizohen duke marrë parasysh komentet apo sugjerimet nga palët e interesuara. Kjo do të përbëjë një aspekt shtesë për përpjekjet avokuese të koalicionit.
- CARs kombëtare do të përmblihen në *Raportin Rajonal Anti-korrupsion*. Ky i fundit do të publikohet dhe shpërndahet në vendet e koalicionit. Në një kapitull të veçantë të raportit do të diskutohen masat për përmirësimin e aktivizmit qytetar dhe të dialogut shtet-shoqëri civile në nivel rajonal dhe kombëtar në fushën e mirëqeverisjes dhe anti-korrupsionit. Raporti gjithashtu do të ndjekë çështjet e përshkruara në *Axhendën e Veprimit*.
- CARs dhe RAR do të fokusohen në çështjet kryesore anti-korrupsion, mangësitë legjislative dhe institucionale ndaj korrupsionit në nivel rajonal dhe kombëtar dhe në masat e nevojshme në linjë me tematikën e mëposhtme:
  - Krijimi i një mjedisi të favorshëm institucional dhe ligjor për frenimin e korrupsionit;
  - Masat për të përmirësuar aktivizmin qytetar dhe dialogun shtet-shoqëri civile në nivel rajonal dhe kombëtar në fushën e mirëqeverisjes dhe anti-korrupsionit;
  - Reformimi i Sistemit Gjyqësor;
  - Frenimi i Korrupsionit në Ekonomi;
  - Rritje të Kontrollit Qytetar dhe Luftës Kundër Korrupsionit;
  - Ndryshim të Perceptimit Publik për Korrupsionin;
  - Bashkëpunim Ndërkombëtar.

#### **Linja e veprimit 5: Avokimi dhe Sensibilizimi**

SELDI do të organizojë një numër ngjarjesh publike me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira, prezantimin e rekomandimeve mbi politikën dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik lidhur me korrupsionin dhe anti-korrupsionin në rajon:

- **Konferenca e hapjes**, duke përfshirë një workshop mbi politikën në mbledhjen e parë të Komitetit Drejtues, dhe do të shërbejë për konsultimet përfundimtare dhe miratimin e *Strategjisë dhe Axhendës së Veprimit*.

- **Workshop-i për politikat dhe avokimin** dhe mbledhja e dytë e Komitetit Drejtues do të grumbullojë OJF-të dhe palët e interesuara për të diskutuar dhe miratuar gjetjet fillestare të raporteve kombëtare dhe të *Raportit Rajonal Anti-Korrupsion (RAR)*. Diskutimi do ketë në fokus çështjet më të ngutshme të identifikuar, duke përfshirë tema të tilla si: prokurimi publik dhe konçensionet, korrupsioni në dogana, korrupsioni në polici, etj. Vëmendje të veçantë do të kushtohet ndaj masave për përmirësimin e dialogut shtet-shoqëri civile dhe mjedisit për aktivizmin qytetar.
- **Konferenca Përmblyëse/Forumi i politikave rajonale për mirëqeverisje dhe anti-korrupsion** do të ketë si objektivi ndarjen e përvojës së grumbulluar gjatë zbatimit të nismës në dy vitet e para të saj, dhe diskutimin e veprimtarive të mëtejshme. Konferenca do të shërbejë si një platformë për shkëmbim përvoje, të praktikave më të mira dhe për prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore për politikat të përpunuara si rezultat i zbatimit të *Sistemit Rajonal për Monitorimin e Korrupsionit*. Forumi do të jetë takimi i mbylljes në ciklin e parë dyvjeçar të monitorimit, analizës dhe avokimit dhe do të miratojë përfundimet e RAR. Palët e interesuara do të vlerësojnë progresin në zbatimin e *Axhendës së Veprimit* dhe do të identifikojnë fushat kryesore që kërkojnë vëmendje të mëtejshme.

### Linja e veprimit 6: Ndërgjegjësimi publik

Fushata e ndërgjegjëimit publik do të zbatohet nga anëtarët e koalicionit nëpërmjet:

- Takimeve publike të nivelit të lartë, të plotësuara me konferenca shtypi me palët e interesuara, mas-median, dhe me shkrime në shtyp. Komunikatat për shtyp do të shpërndahen në të gjitha ngjarjet publike kyçe të SELDI-it.
- Ngritja e grupeve virtuale të punës rreth temave më të rëndësishme për mirëqeverisjen dhe anti-korrupsionin në rajon dhe përpunimi i një serie përmbledhjesh mbi politikat për *Mirëqeverisje në vendet e Europës Juglindore*.
- Përditësim dhe publicitet nëpërmjet faqes së internetit të SELDI-it.

## VII. Përsosmëri organizative dhe njohuri

### Përsosmëri Organizative

SELDI arrin **përsosmëri organizative** nëpërmjet:

- Grumbullimi sëbashku të **burimeve** të 17 OJF-ve partnere që ndajnë vlera të njëjta dhe janë të përfshira gjerësisht në mirëqeverisje dhe anti-korrupsion në nivel kombëtar. Diversiteti i partnerëve, që përfshin të dyja - OJF lokale të krijuara dhe ato elitë, organizata në nivelet bazë të shoqërisë, do t' i mundësojë koalicionit që të ndërveprojë me lehtësi dhe të tërheqë palët e interesuara;
- Mbështetja në **përvojën e mëparshme të partneritetit** të anëtarëve të tij.

- Strategjia bazohet, dhe pjesërisht përsërit praktikat më të mira të suksesshme anti-korrupsion të nismës *Koalicion 2000* në Bullgari si dhe të nismës rajonale për ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve *Iniciativa e Zhvillimit Ligjor të Evropës Juglindore*. Partnerët kryesore të koalicionit të OJF-ve kanë punuar së bashku në të kaluarën në fushën e mirëqeverisjes dhe anti-korrupsionit dhe kanë njohuri të sprovuara dhe përvojë në këtë fushë.
- Përdorimi i një **qasjeje institucionale** me konsultimet dhe avokimit me palët e interesuara. Kjo qasje mund të përmblihet si më poshtë:
  - **Grup përfitues shumë shtetesh**, i justifikuar në aspektin e përpjekjeve kombëtare të shkëputura në rajon në fushën e përmirësimit të qeverisjes dhe frenimit të korrupsionit;
  - **Qasje Inovative** në sjelljen e institucioneve publike dhe private në një pozicion pune të përbashkët në çështjet e reformave demokratike, veçanërisht në ato të anti-korrupsionit dhe mirëqeverisjes;
  - **Platformë institucionale rajonale e re** - *Raporti Rajonal Anti-Korrupsion* dhe Forumi i Mirëqeverisjes Rajonale dhe Anti-Korrupsionit për bashkëpunimin në mirëqeverisje dhe anti-korrupsion.
- **Një strukturë e hapur qeverisjeje** që lejon përdorim të ekspertizës shtesë nga ekspertë të jashtëm dhe palë të interesuara të ndryshme, menaxhim dhe koordinimin të të gjitha ekipeve të ekspertëve nga partnerët e shumtë të OJF-ve në nivel lokal, përgjegjshmëri dhe monitorim të cilësisë së punës dhe ofrimit të saj në kohë sipas afateve të caktuara. Struktura e propozuar qeverisëse lejon ndërvartësinë midis partnerëve dhe lirinë relative për të organizuar burimet e tyre dhe kohën në përputhje me nevojat e veta dhe kërkesat lokale.
- Sigurimi i **mjediseve të shumta dhe mundësive për avokim dhe ndërgjegjësim**. Cikli dyvjeçar i punës së koalicionit i është përshtatur dy mundësive të mëdha të avokimit. Dokumentet dhe ngjarjet publike të SELDI-it do të ofrojnë një bilanc pozitiv të asaj që është planifikuar në fillim dhe çfarë është arritur në fund, duke përfshirë edhe fushën e përmirësimit të mjedisit për aktivizëm qytetar dhe dialog civil shtet-shoqëri në nivel rajonal dhe kombëtar. Më e rëndësishmja, meqënëse ato do të miratohen nga OJF-të dhe palët e tjera të interesuara, ato do të përmirësojnë mirëkuptimin dhe besimin e ndërsjellë ndërmjet shtetit dhe shoqërisë civile.
- **Përdorimi i burimeve ekzistuese në nivel rajonal**. Duke përfshirë RAI, trupën rajonale ndër-qeveritare anti-korrupsion, në iniciativë do të sigurohet një hapësirë e çmueshme për bashkëpunim me palët e interesuara publike kombëtare dhe rajonale. Gjithashtu do të kontribuohet në qëndrueshmërinë e nismës dhe sensibilizimin më të gjerë dhe më të mirë rreth saj.

## Përsosmëri në Njohuri

SELDI arrin **përsosmërinë në njohuri** me anë të:

- Përdorimit të *Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit* për të analizuar progresin e korrupsionit dhe anti-korrupsionit në rajon, gjë që do ta pajisë koalicionin me një certifikatë të fortë në avokimin e vet për ndryshimet e nevojshme dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi zgjidhjet e politikave specifike. Të dhënat e besueshme të monitorimit do të mbështesin funksionin mbikëqyrës të koalicionit dhe do të rrisin legjitimitetin e tij ndërmjet palëve të interesuara dhe publikut të gjerë. Ato gjithashtu do t' i sigurojnë komunitetit të OJF-ve, por edhe politikëbërësve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, një instrument për monitorimin e progresit anti-korrupsion dhe për diagnostikimin e sektorëve më problematikë apo zonave në nevojë për ndërhyrje. Të dhënat do të fuqizojnë organizatat e përfshira në proces: ato do të marrin një përshkrim analitik të besueshëm të situatës (duke bërë të mundur hartimin e planeve të veprimit dhe strategjive të përshtatshme anti-korrupsion) dhe të japë një arsye të fortë se pse korrupsioni është një problem që ja vlen t' i kushtohet vëmendje nga politika dhe shoqëria civile. Nxjerrja e raporteve diagnostikuese të korrupsionit në nivel rajonal përforcon potencialin e koalicionit të OJF-ve për të vepruar si një njësi efektive rajonal e shoqërisë civile.
- Kombinimi i **shumëllojshmërisë së aftësive** dhe njohurive gjithëpërfshirëse. SELDI plotëson një nga mangësitë më serioze të dijes në rajon në fushën e mirëqeverisjes dhe korrupsionit - atë ndërmjet njohurive teorike dhe atyre praktike, të eksperimentimit në terren. Shkrimja e të dyjave do të prodhojë një përshkrim të fuqishëm dhe të besueshëm, i cili do të ndikojë në debatin publik dhe në politikën e vendim-marrjen për anti-korrupsion dhe mirëqeverisjen në vendet e Evropës Juglindore.
- Lëshimi i **deklaratave, qëndrimeve publike mbi politikat** në formën e raporteve dhe përmbledhjeve të shkurtra, të cilat vënë në dukje gjetjet kryesore të njohurive në gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për qytetarët, politikëbërësit dhe mas-median. Deklaratat e shkruara kanë dobi të ruajtjes dhe transmetimit të njohurive në mënyrë efektive në kohë dhe në gjeografi, gjë e cila lejon konsultime më të mira ndërmjet palëve të interesuara dhe ekspertëve vlerësues.
- Sigurimi i **shqyrtimit rigoroz nga ana e ekspertëve vlerësues dhe procedurave të miratimit publik**. Mbledhja i një Bordi Këshillimor Ndërkombëtar siguron se të gjitha raportet e politikave dhe përmbledhjet e dorëzuara nga SELDI do të merren në shqyrtim dhe do të jepen komente/sugjerime nga ekspertët vlerësues. Përveç kësaj, tekstet e *Agjendës së Veprimit dhe Raportit Rajonal të Anti-Korrupsionit* do të konsultohen paraprakisht me palët kryesore të interesuara për të siguruar mbështetjen e duhur ndaj rekomandimeve për politikat, si dhe dhe një miratim publik të tyre mbasi ato do të jenë siguruar. Këto dy procese të sigurimit të cilësisë kanë

provuar të jenë një nga mjetet më të fuqishme për forcimin e kapaciteteve për analizat dhe avokimin.

- Aplikimi i një **qasjeje rajonale**. Koalicioni jo vetëm që do të përcaktojë sfidat kyçe në çdo shtet, por, më e rëndësishmja, do të identifikojë fushat problematike, të cilat paraqesin kërcënimin më të madh për zhvillimin e vendeve të Europës Juglindore. Krahasimet mes shteteve dhe perspektiva rajonale ofrojnë mundësi të të mësuarit dhe stimuj të fuqishëm për përsosmëri në nivel kombëtar. Kjo kornizë e shkëmbimit dhe ndihmës së ndërsjellë do të nisë një shkëmbim të vazhdueshëm të ideve, do të forcojë frymën e bashkëpunimit ndërmjet partnerëve të SELDI-t dhe do të rezultojë në rekomandimet e politikave të besueshme dhe efektive për rajonin.


SELDI është themeluar nga një grup prej 15 organizatash partnere të shoqërisë civile dhe 2 partnerë shoqëruar nga Europa Juglindore. Sëbashku ata punësojnë në staf më shumë se 180 persona – potencialisht institutet më të mëdha të mendimit dhe veprimit rreth politikave të angazhuara me anti-korrupsionin dhe mirëqeverisjen në rajon. Organizatat partnere shërbejnë si "mobilizuese të rrjetit" për ndërlidhjen me palët e tjera të interesuara dhe OJF-të. SELDI është pjesë e një rrjeti më të gjerë të 18 rrjeteve të mbështetura nga Lehtësimi i Shoqërisë Civile i Instrumentit të BE-së për Asistencë Para-Aderimit, i cili siguron një potencial të madh për sinergji të mëtejshme në luftën kundër korrupsionit në rajon.

Tre elementët kyç në strukturën qeverisëse të SELDI-it janë:

- **Komiteti Drejtues**, i cili përfshin përfaqësues nga të gjithë anëtarët e koalicionit. Komiteti Drejtues është organi kryesor vendim-marrës me qëllim sigurimin e një menaxhimi efikas të koalicionit. Ai do të mbledhet të paktën një herë në vit.
- **Bordi Këshillimor Ndërkombëtar** i liderëve rajonale dhe ndërkombëtare të antikorrupsionit, i cili do të ofrojë drejtimin dhe këshillimin strategjik;
- **Sekretariati**, i cili do të sigurojë pikëmbeshtetjen institucionale të SELDI-it.

Diagrama 2. Qeverisja e SELDI-t

## VIII. Qeverisja e SELDI-t



Në nivel substancial, secili anëtar i koalicionit do të përfshihet në një **cikël monitorimi dhe politikash çdo dy vjet**, duke kulmuar në Forumet Rajonale të Mirëqeverisjes dhe të Politikave Anti-Korrupsion, të cilat do të miratojnë *Raportin Rajonal Anti-Korrupsion*. Kjo pjesëmarrje e dyfishtë do të sigurojë transparencë të lartë dhe përgjegjësi të koalicionit. Ajo do të plotësohet me konsultime të palëve të interesuara dhe përfshirjen e qytetarëve gjatë të gjithë kohëzgjatjes së SELDI-it.



<b>Box 1. Palët e interesuara anti-qeveritare sipas shtetit</b>	
Shteti	Institucion(et) Qeveritare
Shqipëri	Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit, Këshilli i Ministrave; Njësitë e Përbashkëta Hetimore - Tiranë dhe 6 të tjera; Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive
Bullgari	Komisioni për Parandalimin dhe Kundërveprimin ndaj Korrupsionit; Komisioni Parlamentar për Reagimin ndaj Korrupsionit; Komisioni i Këshillit Suprem Gjyqësor për Kundërveprim ndaj Korrupsionit; Komisioni për Vërtetimin e Pronës së Përfitur nga Veprimtari Kriminale; Zyra e Specializuar e Prokurorisë dhe Gjykata mbi Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
Bosnja dhe Hercegovina	Departamenti për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Ministria e Sigurisë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe Bashkërendimit të Luftës kundër Korrupsionit (jo ende plotësisht operative); Departamenti për Krimin e Organizuar, Korrupsionin dhe Krimet e Jakave të bardha të Zyrës së Prokurorëve.
Kroacia	Këshilli Kombëtar për Monitorimin e Zbatimit të Masave Anti-Korrupsion; Komiteti për Monitorimin e Zbatimit të Masave Anti-Korrupsion; Departamenti Anti-korrupsion, Ministria e Drejtësisë, Zyra e Prokurorit të Shtetit/Zyra për Parandalimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Zyra Kombëtare e Policisë për Shtypjen e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; Departamentet Gjyqësore që kanë të bëjnë me korrupsionin dhe rastet e krimit të organizuar; Komisioni Shtetëror për Mbikëqyrjen e Procedurës së Prokurimit Publik; Komisioni për Parandalimin e Konfliktëve të Interesit; Zyra Qeveritare për Bashkëpunim me OJQ-të
FYR Maqedonia	Zyra e Prokurorit Publik dhe Zyra Themelore e Prokurorit Publik për Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit; Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Njësia Anti-Korrupsion brenda Departamentit të Krimit të Organizuar në Ministrinë e Brendshme, Zyra e Auditit Shtetëror, Ministria e Drejtësisë; Trupi Ndërsektorial për Koordinimin e Aktiviteteve në Luftën kundër Korrupsionit në Republikën e Maqedonisë; Këshilli i Transmetimeve; Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
Mali i Zi	Drejtoria për Iniciativën Anti-Korrupsion; Komisioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesave; Prokuroria Speciale për Krimin e Organizuar, Korrupsionin, Terrorizmin dhe Krimet e Luftës; Komisioni Trepalësh për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Institucioni Shtetëror i Auditimit; Komisioni Shtetëror Zgjedhor (Financimi i Partive Politike); Komisioni Parlamentar për Anti-Korrupsion
Serbia	Agjencia Anti-Korrupsion, Këshilli Anti-Korrupsion; Departamenti për veprat penale të korrupsionit brenda Policisë dhe Zyrës së Prokurorit Publik; Institucioni Shtetëror i Auditimit; Komisioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Drejtave të Ofertuesve; Komisioneri për Informim të Interesit Publik dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale; Policia, Ministria e Brendshme, Zyra e Prokurimit Publik; Gjykata Administrative, Administrata për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Kosova	Agjencia Kundër Korrupsionit; Përfaqësuesi Special Evropian; Task Forca anti-korrupsion e Kosovës, Zyra e Prokurorit të Shtetit
Turqia	Komiteti Ekzekutiv për Rritjen e Transparencës dhe Luftën kundër Korrupsionit

**IX. Sinergjia me iniciativa të tjera të BE-** *Strategjia dhe Plani i Veprimit i SELDI-it* kërkon sinergji me një numër organesh të tjera dhe iniciativash të BE-së në fushën e anti-korrupsionit, të tilla si:

- ANTICORRP, ende projekti më i madh kërkimor i financuar në kuadrin e Programit të Shtatë të BE-së për kërkime;
- DG Home, DG Justice, OLAF, FRONTEX, dhe iniciativa për të zbatuar *Programin e Stokholmit dhe Planin e Veprimit*; p.sh. Grupi i Ekspertëve të BE-së mbi Korrupsionin, etj.
- sinergji shtesë mund të kërkohen me Strategjinë e Këshillit të Evropës për Inovacionin dhe Mirëqeverisjen në nivel lokal dhe Markën Europiane të Ekselencës në Qeverisje.

SELDI do të identifikojë personat e kontaktit nga organet e BE-së për konsultime në elaborimin *Raporteve Rajonale të Vlerësimit të Korrupsionit* të vendit dhe atyre rajonale.

SELDI do të kërkojë të përfshijë në aktivitetet e tij organet ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe OJF-të me ndikim të rëndësishëm mbi anti-korrupsionin në rajon gjithashtu do të jenë të përfshira, të tilla si: Komisioni Evropian (DG për Zgjerim, DG Home); Këshilli i Evropës; OLAF; GRECO; UNDP dhe UNODC, RAI, CEI, SECI, SEECF, Transparenca Nderkombetare, Banka Botërore dhe BERZH).

**X. Rezultatet dhe Ndi** *Strategjia dhe Plani i Veprimit* pritet të japin **produktet dhe rezultatet** e mëposhtme:

- Përmirësimi i kapacitetit të OJF-ve dhe shoqërisë civile për të monitoruar, analizuar dhe propozuar masa antikorrupsion dhe mirëqeverisjen.
- Sigurimi i mekanizmave të monitorimit të korrupsionit dhe materialeve të trajnimit, përvijës dhe njohurive për OJF-të dhe qytetarët në mënyrë që t' i fuqizojnë ata me të dhëna statistikore dhe informacione analitike të nevojshme për të argumentuar qartësisht nevojën për ndryshim në politikat publike.
- Zbatimi i *Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit* dhe nxjerrja e të dhënave statistikore dhe indekseve krahasuese të korrupsionit në të gjitha vendet e përfshira.
- *Raporti i Vlerësimit të Korrupsionit* specifike për vendin dhe *Raporti Rajonal Anti-korrupsion*, duke përfshirë rishikimin e strategjive anti-korrupsion; vlerësimin e politikave të zbatuara; inventarizimin e praktikave më të mira; rekomandimet e politikave.
- Nisja e një praktike rajonale të përbashkët ndërmjet anëtarëve të koalicionit të OJF-ve, e cila nuk do të kërkojë ndihmë financiare nga nisma. Ajo do të bazohet në kontaktet e vendosura ndërmjet OJF-ve. Koncepti bazë i programit do të jetë ofrimi i udhëtimeve të punës të përbashkëta të papaguara

të OJF-ve të rrjeti SELDI që mund të mbahen në më shumë se një shtet apo institucion.

- Vendosja e çështjes së transparencës, mirëqeverisjes dhe të korrupsionit në axhendën e politikave në vendet e Europës Juglindore dhe fillimi i ndryshimeve në qëndrimet e shoqërive në rajon duke ulur tolerancën ndaj korrupsionit përmes avokimit publik dhe fushatave të ndërgjegjësimit.
- Institucionet qeveritare do të njohin rëndësinë dhe vlerën e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në proceset e reformave për mirë qeverisje dhe anti-korrupsion. Ky rezultat do të arrihet nëpërmjet monitorimit, përsosmërisë së kërkimit, dhe avokimit. Qeveritë kanë prirje për ta njohur dhe për ta marrë në konsideratë përsosmërinë, veçanërisht kur ajo vjen nga rrjetet e larmishme të OJF-ve, të afta për t' i ofruar në mënyrë efektive burimet e tyre ndërkombëtarisht të tilla si SELDI.

Ky veprim pritet të arrijë **ndikimin** e mëposhtëm:

- Sigurimi i OJF-ve me metodologjinë dhe trajnimin e përshtatshëm dhe kështu fuqizimin e komunitetit më të gjerë të OJF-ve (të paktën 60 OJF) dhe qytetarëve me të dhënat statistikore dhe informacion analitik. Ata duhet të dëshmojnë në mënyrë të qartë nevojën për politikën në fushën e mirëqeverisjes dhe antikorrupsionit;
- Rritja e kapaciteteve të shoqërisë civile për të monitoruar, analizuar dhe propozuar masat e transparencës dhe mirëqeverisjes nëpërmjet raporteve të politikave të përgatitura në nivelin më të lartë: *një strategji dhe axhenda e veprimit e SELDI-t, një Raport Rajonal Anti-Korrupsion* dhe nëntë raporte kombëtare të *Vlerësimit të Korrupsionit*; të miratuara nga qeveritë kombëtare; dhe në marrëveshje me qeveritë për të zbatuar të paktën pesë masa specifike anti-korrupsion (p.sh. legjislacioni, kodet e sjelljes, etj);
- Krijimi i një instituti virtual rajonale të mendimit dhe veprimit të mirëqeverisjes dhe anti-korrupsionit, i cili njihet me anë të letrave të miratimit nga qeveritë në rajon, nga Komisioni Evropian dhe nga palë të interesuara publike rajonale;
- Vendosja e çështjes së korrupsionit në axhendën e politikës në vendet e Europës Juglindore; reduktimi i skepticizmit dhe ulja e tolerancës ndaj korrupsionit në rajon;
- Rritja e cilësisë së publikimeve dhe veprimtarisë së mas-medias mbi këtë çështje; ndihmesë me të paktën katër raporte rajonale investigative të korrupsionit;
- Nisja e një ndryshimi në qëndrimet e shoqërisë dhe ulja e tolerancës ndaj korrupsionit, i cili do të ulte presionin korruptiv; do të synonte për të kontribuar në reduktimin e vlerave mesatare rajonale të presionit korruptiv dhe viktimizimin e korrupsionit me të paktën 10%.

## XI. Qendrueshmeria

Veprimtaritë e SELDI-it tashmë janë një vazhdim i dy nismave të mëparshme të suksesshme, të cilat kanë synuar monitorimin e anti-korrupsionit dhe avokimit. Mundësia e zgjerimit të mëtejshëm të kësaj nisme është shumë e lartë, me kusht që të sigurohet financimi i përshtatshëm. *Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit* është një metodë e themeluar, e përdorur në Bullgari për vezhgimet e rregullta të korrupsionit dhe përpunimin e *Raporteve vjetore të Vlerësimit të Korrupsionit* (botuar që nga viti 1999). E njëjta metodologji është aplikuar në vitin 2001 dhe 2002 në vendet e Europës Juglindore. Nisma aktuale ka shanse shumë të larta për të arritur një efekt të shumëfishtë sepse ajo do të ushqejë pilotimin e *Raportit Anti-Korrupsion të BE-së* në vitin 2013. Ky i fundit ka të ngjarë të përdorë masa dhe analiza të ngjashme, të cilat do të lejojnë integrimin më të mirë në të të rezultateve të veprimit të tanishme. Për më tepër, të gjitha vendet përfituese të veprimtarisë kanë perspektiva antarësimi në BE. Përdorimi i të njëjtës metodologji për këtë raund të monitorimit të korrupsionit në 2013-2014 si në 2001 - 2002 në vendet e Europës Juglindore siguron **krahasueshmërinë e rezultateve**, identifikimin e **prirjeve**, dhe vlerësimin e **ndikimit të politikave** të aplikuara për masat anti-korrupsion. Një tjetër vend për efektet e shumëfishtë do të kërkohej nëpërmjet përfshirjes së RAI-t, gjë që mund ta bëjë SELDI-n një platformë të rëndësishme rajonale për monitorimin, avokimin dhe analizën anti-korrupsion.

## Annex 1. Anëtarët themelues të SELDI-t


### Sekretariati



Qendra për Studimin e Demokracisë (CSD), Bullgari, Organizatë joqeveritare

Faqe interneti: [www.csd.bg](http://www.csd.bg)

### Anëtarët e SELDI-t



Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), Shqiperi, Organizatë joqeveritare

Faqe interneti: <http://www.acer.org.al/>



Shtëpia e Europës (HoE), Shqipëri, Organizatë joqeveritare

Faqe interneti: [www.houseofeurope.org](http://www.houseofeurope.org)



Qendra për Raportimin Investigativ (CIN), Bosnje Hercegovinë, Shoqëria e qytetarëve Shoqata e qytetarëve (ekuivalente me organizatë joqeveritare)

Faqe interneti: [www.cin.ba](http://www.cin.ba)



Partneriteti për Zhvillim Social (PSD), Kroaci, organizatë jofitimprurëse, joqeveritare

Faqe interneti: [www.psd.hr](http://www.psd.hr)



INSTITUTI RIINVEST, Kosovë, Organizatë joqeveritare

Faqe interneti: [www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)



Syri i Vizionit

“Syri i Vizionit”, Kosovo, organizatë jofitimprurëse (OJF)

Faqe interneti: [www.syriivizionit.org](http://www.syriivizionit.org)



MACEDONIAN  
CENTER  
INTERNATIONAL  
COOPERATION  
M C I C

**Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCIC), Republika e Maqedonisë, Shoqatë (organizatë e shoqërisë civile)**

Faqe interneti: [www.mcims.mk](http://www.mcims.mk)



**Instituti për Demokraci "Societas Civilis" Shkup (IDSCS), Republika e Maqedonisë, Shoqëria e qytetarëve**

Faqe interneti: [www.idscs.org.mk](http://www.idscs.org.mk)



**Instituti i Ohrit për Strategjitë Ekonomike dhe Çështjet Ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë, Shoqëria e qytetarëve**

Faqe interneti: [www.oi.org.mk](http://www.oi.org.mk)



**Qendra për Tranzicion Demokratik, Mali i Zi, Organizatë joqeveritare**

Faqe interneti: [www.cdtmn.org](http://www.cdtmn.org)

institut alternativa

**Instituti Alternativ, Mali i Zi, Organizatë joqeveritare (shoqatë)**

Faqe interneti: [www.institut-alternativa.org](http://www.institut-alternativa.org)



**Qendra për Studime Liberal-Demokratike (CLDS), Serbi, Organizatë joqeveritare**

Faqe interneti: [www.clds.rs](http://www.clds.rs)



**Forum i Veprimit Qytetar FORCA Pozega, Serbi, Organizatë joqeveritare**

Faqe interneti: [www.forca.rs](http://www.forca.rs)



**Fondacioni Turk Ekonomik dhe Social, Organizatë joqeveritare**

Faqe interneti: [www.tesev.org.tr](http://www.tesev.org.tr)

**Shoqatat**



**Iniciativa Rajonale Antikorrupsion (RAI)  
Sekretariati, Bosnje Hercegovinë, Entitet  
juridik me status diplomatik**

**Faqe interneti: [www.rai-see.org](http://www.rai-see.org)**



**Instituti Ligjor i Kosovës (KLI), Kosovë,  
Organizatë Joqeveritare, jofitimprurëse**

**Faqe interneti: <http://www.kli-ks.org/>**

## Aneksi 2. Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit

Të dhënat për *Raportet e Vlerësimit të Korrupsionit* kombëtare dhe *Raportet Rajonale Antikorrupsion* për Evropën Juglindore do të mblidhen nëpërmjet vërtetimit në terren duke përdorur intervistat e drejtpërdrejta me kryefamiljarët në përputhje me *metodologjinë e Sistemit të Monitorimit të Korrupsionit*. Për procedurën e formimit të shembullit do të përdoren vlerësimet më të fundit të popullsisë në secilin vend. Si një rregull i përgjithshëm, SELDI do të përdorë për këtë vërtetim një shembull të rastit, të shtresuar, në dy faza, duke marrë parasysh tipin e vend-banimit dhe klasifikimet ekonomike dhe gjeografike rajonale. Procedura e formimit të shembullit do të hartohet sipas vërtetimit të Monitorimit Rajonal Korrupsionit të kryera nga SELDI në vitet 2001 dhe 2002 në një numër vendesh të Evropës Juglindore. Madhësia gjithsej e shembullit për çdo vend do të jetë 1,000 persona të intervistuar. Metoda e vërtetimit do të mbetet e pandryshuar për të dy vërtetimet: 2001/2002 dhe 2013/2014.

### Hyrje

System i Monitorimit të Korrupsionit (CMS) u prezantua nga Qendra për Studimin e Demokracisë në 1998, dhe përfshin **një sistem të studimeve empirike dhe raporteve analitike**. Objektivi kryesor i CMS është të paraqesë periodikisht informacionin, i cili do të mundësojë nxjerrjen e përfundimeve rreth shtrirjes së korrupsionit në një vend dhe sjelljes publike, vlerësimeve, dhe pritshmërive që lidhen me të.

Funksionet themelore të CMS janë të lidhura me produktin kryesor të tij - Indekset e Korrupsionit. Indekset e Korrupsionit janë të bazuara në vërtetimet e përfshira në CMS dhe përmbledhin treguesit më të rëndësishëm të korrupsionit që vlerësojnë/masin nivelin e përhapjes së praktikave korruptive në sfera të ndryshme shoqërore.

CMS bazohet në vërtetimet përfaqësuese kombëtare të popullsisë së moshës mbi 18 vjeç. Informacioni është mbledhur rreth opinionit publik mbi çështjet kryesore të mëposhtme:

- Qëndrimet publike ndaj korrupsionit;
- Identifikimi i llojeve të ndryshme të sjelljes korruptive;
- Përvoja personale dhe përfshirja e të intervistuarve në praktika korruptive;
- Nivelet dhe fusha e korrupsionit;
- Përhapja e korrupsionit ndërmjet grupeve të ndryshme profesionale dhe në institucionet publike;
- Pritshmëritë në lidhje me korrupsionin, etj.



### Përforcimi Teorik i Indekseve të Korrupsionit

Indekset e korrupsionit janë një sistem treguesish sintetikë, të cilët paraqesin rezultatet nga vrojtimet sasiore të CMS në një formë të përmbledhur. Objektivi kryesor në ndërtimin e indeksve të korrupsionit është që të zvogëlojë dimensionin e shumëanshëm të korrupsionit, si një fenomen social, në një tërësi të kufizuar treguesish sintetikë. Avantazhet e një qasjeje të tillë janë të paktën si vijon:

- Treguesit sintetikë (Indekset e Korrupsionit) lehtësojnë prezantimin publik të rezultateve, duke i bërë analizat më të lehta për t' u perceptuar;
- Përdorimi i treguesve sintetikë është një parakusht për krijimin e serive kohore dhe, në këtë mënyrë, për analizën dhe vlerësimin e ndryshimeve.

**Katër llojet e indeksve të korrupsionit** janë bazuar në një rikonstruksion relativisht të thjeshtë teorik të elementeve të veprimit shoqëror:

- Veprimi social ka parakushtet e veta të veçanta, ndër të cilat më të rëndësishme janë: qëndrimet e aktorëve socialë, vlerat e brendshme, dhe mënyra se si aktorët e perceptojnë mjedisin e tyre shoqëror;
- Veprimi social në vetëvete presupozon një raport reciprok të veçantë të palëve të interesuara, në të cilën ata shkëmbejnë burimet që zotërojnë për të arritur një objektiv të veçantë;
- Rezultatet nga këto veprime përfshijnë disa karakteristika të veçanta: 1) ata ndryshojnë ose ruajnë parakushtet (para-veprimet) fillestare; dhe 2) ata lënë një "gjurmë" të veçantë në mjedisin social (ndryshojnë ose ruajnë përbërësit e saj strukturorë);
- përmbushja ose mospërmbushja e objektivave prodhon pritshmëri në radhët e aktorëve rreth karakterit dhe strukturës së veprimit social në ciklin e tij të mëvonshëm. Bazuar në këto parashikime, secili aktor ndërton ose ndryshon strategjinë e tij/saj të sjelljes.

I aplikuar për korrupsionin, ky model i veprimit social mund të përmbledhet në komponentët themelorë të mëposhtëm:

<b>Përbërësit e Veprimit</b>	<b>Përbërësit e Sjelljes Korruptive</b>
Parakushtet e Veprimit	<i>Sjellja kundrejt korrupsionit</i> Përfshin identifikimin e korrupsionit si një fenomen social, vlerësimin e lejueshmërisë së tij normative (vlera), dhe shkallën e gatishmërisë për të shkelur normat e sjelljes sociale legjitime.
	<i>Praktikat korruptive</i>

Ndërveprimi i palëve të interesuara	Përfshin veprimtaritë e aktorëve në krijimin e një parakushti për praktikën korruptive (p.sh. ushtrimi i presionit), dhe veprimeve aktuale të sjelljes korruptive.
Rezultatet e veprimit	<i>Vlerësimi i madhësisë së korrupsionit</i> Përfshin vlerësimin e nivelit të përhapjes (përfshirjen) e zyrtarëve publikë në forma të ndryshme të sjelljes korruptive, si dhe vlerësimin e niveleve të transformimit të korrupsionit në një normë të sjelljes (në një instrument shoqëror efektiv për zgjidhjen e problemeve personale).
Pritshmëritë	<i>Vlerësimi i perspektivave mbi korrupsionin</i> Përfshin vlerësimet e aftësisë së shoqërisë (p.sh. potenciali i saj), për të luftuar korrupsionin.

Duhet të theksohet se aplikimi i modelit të përgjithshëm të veprimit social (madje edhe në formën e saj të thjeshtuar) ndaj korrupsionit (në ndërtimin e metodologjisë së studimeve sasiore) është subjekt i kufizimeve të shumta. Prandaj, modeli mbi të cilin bazohet studimi i sjelljes korruptive është thjeshtuar. Në ndërtimin e një sërë treguesish të përdorur në realitet, objektivi ishte për të përdorur minimumin e domosdoshëm në një mënyrë që të ruhen standardet profesionale të punës në terren.

### Struktura e Indekseve të Korrupsionit

CMS përfshin katër lloje indeksesh:

- **Sjellja kundrejt korrupsionit**
  - (Parimi) Pranueshmëria e Korrupsionit: Indeksi pasqyron shkallën në të cilën popullsia pranon, në një nivel vlere, veprime të caktuara të sjelljes korruptive në emër të anëtarëve të parlamentit dhe zyrtarëve publikë.
  - Ndjeshmëria ndaj Korrupsionit: ky indeks mat prirjen për kompromis mbi vlerat, parimet, dhe ligjshmërinë, në mënyrë që të kryehen akte korruptive, të tilla si dhënia ose pranimi i parave dhe/ose dhuratave me qëllim zgjidhjen e problemeve të caktuara personale.
- **Praktikat Korruptive**
  - Presioni i Korrupsionit mbi Publikun e Përgjithshëm: Ky indeks tregon shkallën në të cilën qytetarët janë subjekt i presionit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për të marrë pjesë në praktika korruptuese me zyrtarët publikë. Ajo është përgjegjëse për rastet,

në të cilat zyrtarët publikë kanë kërkuar ose treguar se ata prisnin sjellje korruptive nga qytetarët.

- Përfshirja personale në veprat e sjelljes (së përgjithshme publike) të korruptuar: ky indeks reflekton vetë-rrëfime në lidhje me rastet, në të cilat qytetarët u kanë ofruar para dhe/ose dhurata zyrtarëve publikë.
- **Madhësia e Korrupsionit**
  - Përhapja e Korrupsionit: ky indeks pasqyron vlerësimin e qytetarëve për përhapjen e korrupsionit në vend. Ai gjithashtu mund të llogaritet për grupe specifike të zyrtarëve publikë dhe institucionet publike.
  - Efektiviteti praktik i sjelljes së korruptuar: ky indeks tregon shkallën në të cilën qytetarët e perceptojnë korrupsionin si një mjet efikas për zgjidhjen e problemeve personale. Ai bazohet në probabilitetin e regjistruar të qytetarëve që ofrojnë të holla dhe/ose dhurata në mënyrë që të zgjidhin me sukses problemet e tyre.
- **Pritshmëritë e së Ardhmes së Korrupsionit:** ky indeks reflekton pritshmërinë e publikut të zakonshëm në lidhje me kapacitetin e shoqërisë për të frenuar korrupsionin në vend.

### Interpretimi i Indekseve të Korrupsionit

Korrupsioni është një dukuri komplekse dhe shumëdimensionale, e shoqëruar me disa përkufizime të ndryshme. Përkufizimi operacional i përshtatur nga CMS e përkufizon korrupsionin si shpërdorim të pushtetit (ekonomik, politik dhe administrativ) në interes të përfitimit personal ose të grupit dhe në kurriz të individëve ose grupeve specifike apo shoqërisë në tërësi. Ky përkufizim mjaft i gjerë garantohet nga karakteri i vetë dukurisë, si dhe nga nismat me fushë të gjerë veprimi (të qytetarëve dhe qeverive) kundër korrupsionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Riprodhimi i korrupsionit presupozon ekzistencën e katër komponenteve të nevojshme: 1) zyrtarët shtetërorë/publike; 2) pushtet për të vepruar lirshëm; 3) shpërdorimi i pushtetit publik, dhe 4) përfitime private të zyrtarëve. Në varësi të manifestimit të këtyre komponentëve, ekzistojnë forma, nivele, fusha, dhe mekanizma të ndryshme për korrupsionin.

Korrupsioni manifestohet kryesisht përmes ndërveprimeve midis sektorit publik, nga njëra anë, dhe qytetarëve dhe biznesit privat, në tjetrën. Ka dy **lloje bazë të korrupsionit:**

- Korrupsioni i madh (shpesh referohet edhe si "korrupsioni politik"), i cili përfshin zyrtarë të lartë shtetërorë, politikanë dhe njerëz të biznesit, dhe i referohet alokimit të burimeve të konsiderueshme, dhe

- Korrupsioni i vogël, i cili zakonisht përfshin zyrtarët e nivelit të ulët publik, dhe i referohet ndërveprimeve të përditshme mes tyre dhe qytetarëve e bizneseve (të vogla dhe të mesme). Ky lloji i dytë është më i përhapur, dhe është i lidhur me pagesat e vogla dhe/ose sistemit të favoreve dhe dhuratave.

Duke mbajtur parasysh objektivat specifike të sjelljes korruptive duhet të merren në konsideratë dy **raste** specifike **të korrupsionit**:

- Së pari, abuzimi me pushtetin për përfitime private, në rastet kur zyrtarët janë të detyruar që të ofrojnë një shërbim të caktuar me ligj. Ky lloji i korrupsionit, i njohur si "grasatim i rrotave", është vënë në shënjestër si ofrimi më i shpejtë apo më i përshtatshëm i shërbimeve, apo siguri më të madhe në zgjidhjen e problemeve.
- Një rast i dytë është kur një zyrtar ofron shërbime/të drejta, për të cilat qytetari (biznesi) nuk ka të drejtë me ligj, apo kur shërbimet janë në shkelje të drejtpërdrejtë të ligjit.

Nga këndvështrimi ekonomik, përhapja e korrupsionit ndjek parimet klasike të kërkesës dhe ofertës së tregut: një kërkesë e madhe dhe një liri e madhe për të vepruar e zyrtarëve prodhon një mjedis që lehtëson dhe nxit korrupsionin. Vlera e ryshfetit varet nga fitimi apo përfitimi i pritshëm. Në këtë aspekt, sjellja e korruptuar mund të konsiderohet si transaksion ekonomik reciprokisht i dobishëm. Megjithatë, këto transaksione eliminojnë rregullat e konkurrencës dhe rregullimet ligjore, dhe në këtë mënyrë shtrembërojnë parimet e tregut dhe kriteret për veprim ekonomik dhe vendim-marrje efikase.

Përkufizimi i korrupsionit si një dukuri negative shoqërore lejon të bëhen disa supozime, përsa i përket interpretimit të treguesve të përfshirë në CMS:

- Në një gjendje ideale të shoqërisë (mungesa praktike e korrupsionit), sjelljet korruptive duhet të kenë vlera minimale: dmth qytetarët duhet ta perceptojnë sjelljen e korruptuar, si moralisht të papranueshme dhe nuk duhet të jenë të prirur të kompromentojnë vlerat e tyre morale. Intensiteti i sjelljes korruptive duhet të jetë minimal, dhe sjellja e korruptuar duhet të ketë një vlerësim të ulët, si një praktikë efektive për zgjidhjen e problemeve.
- Do të ishte logjike të supozohej se ekzistenca e një niveli të caktuar të tolerancës ndaj sjelljes korruptive (pranueshmëria morale), do të ketë disa pasoja:
  - Së pari, gatishmëria për kompromis do të rritet, meqënëse niveli i tolerancës rritet.
  - Së dyti, shpeshësia e akteve praktike të korrupsionit do të rritet me rritjen e nivelit të tolerancës (për shkak të "intensitetit natyror" të konformitetit social).

- Së treti, në rastet kur frekuenca e sjelljes korruptive tejkalon nivelin e "raste të vetme të izoluar", ka të ngjarë që vlerësimet e përhapjes së korrupsionit do të tejkalojnë ndjeshëm frekuencën e akteve praktike të sjelljes korruptive (vetëm një rast "i marrjes së një ryshfeti" do të jetë e mjaftueshme që një zyrtar të etiketohet nga shoqëria si "i korruptuar").
- Së katërti, ekzistenca e një mjedisi shoqëror, ku aktet e sjelljes së korruptuar tejkalojnë nivelin e "rasteve të izoluar të vetme", ka shumë gjasa të prodhojnë perceptimin se korrupsioni është një komponent normal i një mjedisi shoqëror. Shanset e këtij perceptimi që të përhapet rriten me zbatimin e kufizuar të mekanizmave të sanksionit.

Një nga supozimet teorike bazë për ndërtimin e CMS është se është më e rëndësishme **të ndiqet dinamika e korrupsionit** në disa dimensione, se sa të analizohen vlerat e tij fillestare/e tanishme. Meqënëse korrupsioni është identifikuar si një problem për shoqërinë, është e rëndësishme të vlerësohet pesha e tij. Megjithatë, është më e rëndësishme të dihet dinamikat e tij: dmth nëse korrupsioni është duke u zhvilluar në një drejtim pozitiv ose negativ në krahasim me vlerat fillestare të tij bazë.

Indekset e korrupsionit sigurojnë një përafrim rreth qëllimit dhe aspekteve të korrupsionit bazuar në vlerësimet e qytetarëve dhe zyrtarëve publikë. Këto vlerësime janë pikënisje për sjelljen e tyre praktike dhe mënyrën se si ata e perceptojnë mjedisin e tyre shoqëror. Indekset e korrupsionit nuk mund të jenë një bazë për të nxjerrë konkluzione të drejtpërdrejta në lidhje me nivelin e saktë të përhapjes së praktikave korruptive.

Ndërkohë që indeksi i përfshirjes personale në praktikat korruptive bazohet në pranimet anonime të të anketuarve, ajo i afrohet "nivelit të përhapjes së korrupsionit". Gjithashtu, në një masë të caktuar, karakteristikat e veçanta ligjore të korrupsionit (që të dyja palët veprojnë në mënyrë të paligjshme) e bëjnë këtë indeks një prej matjeve të pakta aktuale të **nivelit real të përhapjes së korrupsionit**. Në krahasim me informacionin në dispozicion nga institucionet ligjëzbatuese në rajonin e Europës Juglindore, niveli i saktësisë së matjeve të vrojtimit empirik të realitetit të korrupsionit është shumë më i lartë.

### **Metodat e Llogaritjes së Indekseve të Korrupsionit**

Metoda e përdorur në ndërtimin e indekseve të korrupsionit përfshin hapat e mëposhtëm:

1. Një shkallë (e cila varion 0-3) i caktohet secilës vlerë të një treguesi, i cili nga ana e tij rrjedh nga pyetjet e vrojtimit.
2. Çdo shkallë ponderohet me përqindjen e të intervistuarve, të cilët kanë zgjedhur opsionin e përgjigjeve përkatëse (përfshirë kategoritë "nuk e di" dhe "pa përgjigje").
3. Vlera e treguesit llogaritet si shume e gradëve të ponderuara.
4. Secili indeks korrupsioni përmbledh vlerat e disa treguesve dhe paraqitet në një formë statistikore: nga 0 (nuk ka korrupsion) te 10 (korrupsioni është maksimal).

Shembull: Indeksi për përhapjen e korrupsionit është ndërtuar në bazë të pyetjes së mëposhtme:

*Q. Sipas jush, sa i përhapur është korrupsioni në vendin tuaj (vetëm një përgjigje).*

	Shkalla	Përqindja e vlefshme
1 Pothuajse të gjithë zyrtarët e shtetit janë të përfshirë në të	3	19 %
2 Shumica e zyrtarëve shtetërorë janë të përfshirë në të	2	42%
3 Vetëm pak zyrtarë shtetërorë janë të përfshirë në të	1	38%
4 Rrallëherë përfshihet ndonjë zyrtar shtetërorë	0	1%
9 DK/NA	-	-

$$I = 3 \times 0.19 + 2 \times 0.42 + 1 \times 0.38 + 0 \times 0.01 = 1.79$$

Vlera e indeksit shkon nga 0 në 3. Sa më afër kjo vlerë të jetë me 3, më i përhapur është korrupsioni (sipas vlerësimeve të të inervistuarve).

Në mënyrë që të ndërtohen indekset agregate, vlerat e indekseve individuale janë normalizuar duke i rregulluar që vlerat e tyre të bien në rangun mes 0 dhe 10. Vlerat e normalizuara më pas mbledhen. Për shembull, indeksi për përhapjen e korrupsionit normalizohet duke pjesëtuar vlerën e tij aktuale (1.79) me vlerën maksimale (3.00), duke marrë vlerën e normalizuar (0.60). Kjo vlerë pastaj rillogaritet për t' u përshtatur në një shkallë që varion midis 0 dhe 10.